



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2387/7 prot.

Datë 07.11.2023

V E N D I M

Nr. 1139/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.11.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-74544-07-07-2023, me objekt: “Loti 4: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët - materiale mobilim urban lëndë e parë Faza II”, me fond limit 104,166,667.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Ankimues:

“Albgarden” SHPK me NIPT K37513520N dhe adresë: Lagjja “Skenderbeg”, godinë private 1 katëshe në superstradën Lezhë-Shkodër, km1, Lezhë

Autoriteti Kontraktor:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, Tiranë

Subjekte të Interesuara:

“Leon Konstruksion” SHPK me NIPT: K71820009I dhe adresë: Tirane Rruga Tish Dahia, Kompleksi Kika 2, Pallati nr.9, Kati 8

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.07.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-74544-07-07-2023, me objekt: “Loti 4: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët - materiale mobilim urban lëndë e parë Faza II”, me fond limit 104,166,667.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 10.08.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 13.09.2023 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1- OE “LEON KONSTRUKSION” sh.p.k	85,401,900	leke	kualifikuar
2- OE “Alb Garden” sh.p.k	87,436,000	lekë	kualifikuar
3- OE “POWER INDUSTRIES” sh.p.k,	88,294,400	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 19.09.2023, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike “Njoftimi i Fituesit Paraprak”.

II.5. Në datë 28.09.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3454 dhe me nr. 2387/2023 prot., datë 29.09.2023 e operatorit ekonomik “Albgarden” SHPK ku u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK konkretisht duke pretenduar:

[...]Oferta e OE “Leon konstruksion” sh.p.k. është vlerësuar dhe shpallur fituese paraprake e kësaj procedure prokurimi në kundërshtim të plotë me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, pasi nuk plotëson disa nga kriteret e kualifikimit të kërkuara nga AK.

I. Oferta e paraqitur nga oe ëleon konstruksionë sh.p.k., nuk plotëson kriterin e kualifikimit lidhur me objektin e veprimtarisë.

Në shtojcën 7 formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, pika 1/a. kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit, AK ka vendosur kriterin, si më poshtë: ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posacëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.”*

Në faqen zyrtare të qendrës kombëtare të biznesit në adresën www.qkb.gov.al shkarkuam ekstraktin e thjeshtë të oe ëleon konstruksionë sh.p.k., nga ku rezulton se në datën e zhvillimit të këtij tenderi kjo shoqëri ka në objektin e aktivitetit të saj, si më poshtë:

9. objekti i aktivitetit : ne fushen e ndertimit: germime dheu me punime eventuale murature e beton arme, prishje dhe punime ne toke te germuar, prodhim materiale ndertimi, ndertime civile dhe ekonomike, rrugore. ndertime hekurudhore, ura dhe vepra arti, detare, hidraulike dhe hidroteknike. vepra te vecanta e punime speciale restaurimi, karpentierie, impiante teknologjike e te veáanta. punime montimi ne impiantet e prodhimit dhe shperndarjes se energjise. punime sherbimi, topogjeodezike. ne fushen e tregtise: tregtim te artikujve te ndryshem me shumice dhe pakice te lejuara nga ligji. import, eksport. transport mallrash brenda dhe jashte vendit. transport mbetjesh te rrezikshme dhe jo te rrezikshme. stacion transferimi mbetjesh te rrezikshme dhe jo te rrezikshme. veprimtari e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis, vleresim ndikimi ne mjedis (auditimi mjedisor). veprimtari te tjera profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis, grumbullim dhe trasportim i mbetjeve te ndertimit

dhe prishjeve dhe mbetjeve te ngurta urbane. servis dhe mirmbajtje makinash, riparim dhe rehabilitim ne fushen e automatizimit industrial ne makineri, mjete, pajisje. Lavazh mjetesh, tregtim karburanti. Ne fushen e studimit dhe 2 projektimit urbanistik. ne fushen e studimit dhe projektimit arkitektonik. Ne fushen e studimit dhe projektimit konstruktiv. Ne fushen e studimit dhe projektimit instalator duke pershire projektim te instalimeve hidro-termosanitare. projektim te instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme. projektim te linjave e rrjeteve elektrike, per objekte civile e industriale. Projektim te sistemeve komplekse te telekomunikacionit. projektim te sistemeve te furnizimit me gaz. Projektim te sistemeve kundra zjarrit. Projektim te sistemeve te monitorimit dhe automatizimit ne industri dhe ndertesa. projektimi i impianteve ngritese e transportuese (ashensore, shkalle levizese etj.). projektimi i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndricimit te objekteve te medha sportive, porteve aeroportive etj. Projektim te rrjeteve te telefonise, citofonise, fonise, internetit, tv, access controll, cctv, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit te zjarrit etj., per objektet civile e industriale. Ne fushen e studimit dhe projektimit te veprave hidraulike. Ne fushen e studimit dhe projektimit rrugeve - hekurudhave. ne fushen e studimit dhe projektimit ura vepra arti. Ne fushen e studimit dhe projektimit gjeodezike. ne fushen e studimit gjeologjine inxhinierik - hidrogeologjik. Ne fushen e studimit dhe projektimit i impianteve te prodhimit dhe shperndarjes se energjise elektrike. Ne fushen e studimit dhe projektimit te sinjalizimit rrugor. ne fushen e studimit dhe projektimit te sizmologjise inxhinierike. Ne fushen e studimit dhe projektimit te ndertimit dhe mbylljes se vend-depozitimeve te mbetjeve te ngurta. Ne fushen e studimit dhe projektimit te ndertimit te impianteve te trajtimit te ujerave te zeza. Punime projektimi dhe zbatimi e restaurimi ne monumentet e arkitektures, restaurimi i monumenteve te trashegimise kulturore, nderhyrje ne qendra historike dhe kulturore. Ndertime impiante per prodhimin e energjise elektrike, nenstacioneve dhe kabina te tensionit te larte, te mesem dhe te ulet. Agjenci imobiliare, konsulence, marketing, genplan, ndermjetesim shitje, blerje, dhenie apo marrje me qira te pronave te paluajtshme, studime tregu te pasurive te paluajtshme etj. Ndërkohë, kjo procedurë prokurimi, ka objekt të prokurimit: Lloti 4: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët - materiale mobilim urban lëndë e parë faza II.”

Gjithashtu, në shtojcën 6 të DST-ve, AK-ja ka publikuar sasinë dhe grafikun e produkteve që prokurohen, duke përcaktuar llojin e produkteve, si më poshtë: materiale për mobilim urban, si: ëstola me krah gize, stola betoni, kosha mbeturinash dhe kazanë plastikë. materiale për gjelbërim, si: ëfidanë dekorativë të llojeve të ndryshme dhe shkurreë. nga verifikimi i objektit të vepimtarisë së OE “Leon Konstruktion” sh.p.k., rezulton se kjo kompani nuk ka në objektin e vepimtarisë së saj objektin e prokurimit dhe konkretisht tregtimin e materialeve për mobilim urban dhe tregtimin e materialeve për gjelbërim. Gjithashtu, ne si operator ekonomik kemi një eksperiencë rreth 30 vjecare në aktivitetin e tregëtimit të pemëve, drurëve, fidanëve dhe bimësisë dekorative dhe gjatë gjithë aktivitetit tonë prej afro 3 dekada, në asnjë moment nuk e kemi hasur apo ndeshur diku oe ëleon konstruktionë sh.p.k., si një kompani që ushtron aktivitet tregtar në fushën e tregëtimit apo prodhimit të bimësisë dekorative. Bazuar në gjithë arsyetimin dhe argumentet e mësipërme ngrejmë pretendimin e arsyeshem se OE “Leon Konstruktion” sh.p.k., nuk e plotëson kriterin kualifikues të sipërpërmendur.

II. Oferta e paraqitur nga OE “Leon Konstruksion” sh.p.k., nuk plotëson kriterin e kualifikimit për punë të ngjashme. Në shtojcën 7 formulari i kriterëve të perzgjedhjes/kualifikimit, pika 2. kriteret e vecanta të kualifikimit, nënpika 2.9 kapaciteti teknik, ak ka kërkuar kriterin:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

g) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

h) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Referuar preventivit të publikuar nga AK në DST rezulton se artikujt që kërkon loti 4 janë: materiale për mobilim urban, si: “Stola me krah gize, stola betoni, kosha mbeturinash dhe kazanë plastik”. Materiale për gjelbërim, si: Fidanë dekorativë të llojeve të ndryshme dhe shkurre”. Nga një kërkim i thjeshtë në faqen e web-it: <https://openprocurement.al/>, vërejmë se ky operator ekonomik ndër vite ka realizuar vetëm kontrata punimesh civile dhe jo kontrata malli bashklidhur tabela nr.1 ne formatin pdf tek hapsira dokumentat qe ngarkohen nga aplikanti.

Pra kjo shoqëri, ka kryer ndër vite gjatë veprimtarisë së saj vetëm punime civile dhe nuk ka asnjë kontratë të ngjashme lidhur me furnizimin e materialeve si më poshtë: materiale për mobilim urban, si: “stola me krah gize, stola betoni, kosha mbeturinash dhe kazanë plastik”. Materiale për gjelbërim, si: “fidanë dekorativë të llojeve të ndryshme dhe shkurre”. Në nenin 87 “kriteret për shpalljen e ofertës fituese” të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

“3. kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në cdo drejtim dhe në cdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.” Më tej akoma, në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM nr. 285 datë 19.5.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” përcaktohet se:

2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, sic përcaktohet më poshtë:

i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;

ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe

iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. bazuar në bazën ligjore të sipërcituar, si dhe referuar arsyetimit dhe argumenteve të parashtruara në këtë ankesë, duhet që oferta e kompanisë ëleoon konstruksionë sh.p.k të skualifikohet, pasi nuk ka paraqitur kontrata furnizimi malli të ngjashme me produktet objekt prokurimi, duke sjell si pasojë mos përmbushjen e kriterit kualifikues të sipërpërmendur.

III. Oferta e paraqitur nga OE “Leon Konstruksion” sh.p.k., nuk plotëson kriterin e kualifikimit për disponimin e mjeteve për transportin e mallrave.

Në shtojcën 7 formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, pika 2. kriteret e vecanta të kualifikimit, nën-pika 2.9 kapaciteti teknik, AK ka kërkuar kriterin:

Operatori duhet të disponojë të paktën 4 mjete që nevojiten me qëllim transportin e mallrave, të cilët duhet t’i ketë në pronësi ose me qira.

Nr.	mjetet	sasia	gjendja
-----	--------	-------	---------

1	kamion me vinc	4	pronësi ose me qira
---	----------------	---	---------------------

? Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leja e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshëm.

? për mjetet që janë me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë. oferta e paraqitur nga OE “Leon Konstruksion” sh.p.k., nuk e plotëson këtë kriter kualifikimi të kërkuar në DST pasi:

a) Mjetet e deklaruar nga OE “Leon Konstruksion” sh.p.k. në shtojcën 8 formulari përmbledhes i vetedeklarimit janë të ndryshme nga mjetet të cilat janë dorëzuar po nga ky OE gjatë paraqitjes së dokumentacionit fizik pranë AK. Ky fakt përbën arsye të drejtëpërdrejtë për skualifikimin e OE “Leon Konstruksion” sh.p.k. nga kjo procedurë prokurimi;

b) mjetet e deklaruar nga oe ëleoon konstruksionë sh.p.k. në shtojcën 8 formulari përmbledhës i vetedeklarimit nuk e plotësojnë kriterin e kërkuar në DST nga AK. Pavarësisht se këto mjete janë të vetëdeklaruar nga OE “Leon Konstruksion” sh.p.k. si kamion me vinc, referuar lejes së qarkullimit të këtyre mjeteve nuk rezulton të kenë shënimin përkatës sipas parashikimeve të akteve nënligjore të kodit rrugor. më konkretisht sjellim në vëmendjen tuaj se në nenin 54 të kodit rrugor parashikohet se: “1. Automjetet janë mjete me motor me të paktën katër rrota, me përjashtim të autokarrove. automjetet ndahen në: ?? 1)

Makina ngarkim-transporti: mjete ose komplekse mjetesh që kanë pajisje të veçanta për ngarkimin dhe transportin e materialeve që përdoren, ose janë produkt i punimeve të ndërtimit dhe të gërmimeve në miniera, si dhe të materialeve që plotësojnë gjatë ecjes ciklin e prodhimit të tyre;

këto mjete ose komplekse mjetesesh mund të përdoren në transporte që kalojnë kufirin e ngarkesës të përcaktuar në nenin 62, por jo atë të nenit 10, pika 8; në cdo rast nuk duhet të kalojnë përmasat gabarite kufitare të përcaktuara në nenin 61; makinat e ngarkim-transportit duhet, gjithashtu, të jenë të përshtatshme për t'u përdorur në kantiere ose për përdorim të përzier në rrugë dhe jashtë sajë. më tej akoma, në pikën 2 të nenit 54 të kodit rrugor përcaktohet se: "Në aktet në zbatim përcaktohen, sipas pajisjeve të tyre shoqëruese, tipat e automjeteve që regjistrohen si automjete për transporte të veçanta dhe si automjete për përdorime të vecanta". Referuar lejes së qarkullimit të paraqitur nga OE "Leon Konstruksion" sh.p.k., rezulton se mjetet e paraqitura nuk e kanë shënimin e vecantë në lejen e qarkullimit që provon se këto mjete janë për përdorim apo transport të vecantë. Ky fakt bie në kundërshtim të plotë me kriterin e kërkuar në DST nga AK.

c) nga informacioni që disponojmë për këtë operator ekonomik, na rezulton se për plotësimin e kriterit të mjeteve, kjo shoqëri ka lidhur kontratë qiraje. kontrata e qirasë për mjetet e marra me qira dhe të deklaruara nga o/e leon konstruksionë sh.p.k. në shtojcën 8 formulari permblethes i vetedeklarimit është lidhur në kundërshtim me parashikimet e Kodit Rrugor dhe ligjit "Për transportet rrugore". Më konkretisht ju bëjmë me dije se: në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 "Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve" i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar parashikohet se: "[...] 1. me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike. 2. me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik. 3. mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët. 4. quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.

5. Përdorimi nga të tretët përfshin:

a) dhënien me qira pa drejtues mjeti;

b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish;

c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh;

d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve;

e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave;

f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të treteve. ?.

7.Në aktet në zbatim janë përcaktuar karakteristikat konstruktive të mjetit në lidhje me destinacionin ose përdorimet, për të cilat ai mund të caktohet.

8. Duke përjashtuar dispozitat e ligjeve të posaçme, cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë. [?]"

Më tej akoma, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 ëpër transportet rrugoreë, i ndryshuar, parashikohet se: "[?]"

3.13. transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi.

3.14. transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. [?]"

Ndërsa në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 "për transportet rrugore", i ndryshuar, parashikohet se: "Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.ë referuar kuadrit ligjor të sipërcituar rezulton e qartë se mjeti që jepen

me qira duhet të jenë të pajisur me certifikatën e lëshuar për “Transport për të tretë dhe me qira” përmes të cilës shoqëritë mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. në rastin konkret rezulton se oe ëleon konstruksionë sh.p.k., nuk ka dorëzuar dokumentin certifikatë për “Transport për të tretë dhe me qira”e për rrjedhojë kontrata e qirasë e paraqitur nga ky OE është e pavlefshme duke mos e përmbshur kështu kriterin e kualifikimit të disponimit të 4 mjeteve (kamion me vinc) të kërkuara nga AK në DST. Në nenin 87 “kriteret për shpalljen e ofertës fituese” të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “3. kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në cdo drejtim dhe në cdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

4. kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.” Më tej akoma, në nenin 82 “Shqyrtimi dhe Vlerësimi i Ofertave” të VKM nr. 285 datë 19.5.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” përcaktohet se: 2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe jan? t? p?rgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, sic përcaktohet më poshtë: i.

“Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;

ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe

iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Bazuar në bazën ligjore të sipërcituar, si dhe referuar arsytimit dhe konstatimeve të parashtruara në pikën 2 të ankesës, rezulton se OE “Leon Konstruksion” sh.p.k., nuk e plotëson kriterin e kualifikimit për disponimin e mjeteve sipas kërkesave të AK, e për pasojë kualifikimi i këtij operatori është marrë në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, e për pasojë ky vendim duhet të ndryshojë duke e skualifikuar OE “Leon Konstruksion” sh.p.k.

IV. Oferta e paraqitur nga OE “Leon Konstruksion” sh.p.k., nuk plotëson kriterin e kualifikimit për plotësimin e shtojcës 8 formulari permbledhës i vetedeklarimit sipas përcaktimeve të AK. Nga verifikimi i shtojcës 8 formulari permbledhës i vetedeklarimit të përpiluar dhe dorëzuar nga OE “Leon Konstruksion” sh.p.k., rezulton se të dhënat e paraqitura në këtë formular nuk janë të sakta. Më konkretisht të dhënat e paraqitura nga OE OE “Leon Konstruksion”sh.p.k., për mjetet e kërkuara, si dhe për kontratat e ngjashme rezultojnë të jenë të pasakta. në këto kushte ky OE duhet të skualifikohet. Bazuar në argumentet dhe arsytimin e mësipërm, kërkohmë rivlerësimin e procedurës së prokurimit me

objekt: Marrëveshje Kuadër: “mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët-materiale, lëndë të para, faza II”, i ndarë në 4 Lote; Loti 4 Ref-74544-07-07-2023, me objekt: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët -materiale mobilim urban lëndë e parë faza II.”; me fond limit të marrëveshjes kuadër 104,166,667 lek pa TVSH. sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 988,861.46 Euro, të zhvilluar në datë 10.08.2023 ora 11:00, skualifikimin e OE “Leon Konstruksion” sh.p.k., dhe shpalljen fitues të OE ALBgarden sh.p.k. për këtë procedurë prokurimi.”

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. prot 2387/2 date 29.09.2023, u publikuan kriteret e kualifikimit, të cilat operatori ekonomik ankimues “Albgarden” SHPK SHPK pretendon, se nuk plotësohen nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK.

II.7. Me shkresën nr. 3207/1 prot., datë 03.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2387/3 prot., datë 05.10.2023, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “Albgarden” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke argumentuar: “[...] Komisioni i shqyrtimit të ankesave ps shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur arsyetoi si më poshtë:

Së pari lidhur me pretendimin “Oferta e paraqitur nga OE “LEON KONSTUKSION”sh.p.k nuk ploton kriterin e kualifikimit lidhur me objektin e veprimtarisë” KSHA arsyeton :

Në dokuemntet e tenderit shtojca 7, në pikën 1/a është përcaktuar: “Ofertuesi deklaron se: është i regjistruar në regjistrin tregtar siaps legjislacionit të vendit ku ushtorn aktivitetin ose sipas legjilacionit të posacëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv...”

Nga verifikimi në regjistrin tregtar rezulton në ekstraktin e regjistrit se operatori “LEON KONSTRUKSION” sh.p.k ndër të tjera ka në objektin e veprimtarisë së tij: “...Në fushën e ndërtimit...Në fushen e tregtise: lregtim të artikujve të ndryshëm me shumicë dhe pakicë të lejuara nga ligji. Import, eksport. Transport mallrash brenda dhe jashte vendit...”

Është fakt se operator i renditur i pari ka në veprimtarinë e tij:

-tregtim të artikujve të ndryshëm

-tregtim me shumicë dhe pakisë të artikujve të lejuara nga ligji

-import dhe eksport të artikujve

-transport të mallrave

Në kuptimin gjuhësor kuptimin i fjalës “artikuj” është: “Lloj prodhimi, malli a sendi, i caktuar për t'u shitur. artikuj industrial, artikuj shkollorë (kulturorë, sportive), artikuj të ndryshëm, artikuj ndërtimi. artikuj të përdorimit të gjerë...”

Në bazë të kuptimit të fjalës “artikuj”, i cili është pjesë e objektit të veprimtarisë së operatorit “LEON KONSTRUKSION” sh.p.k, materialet mobilim urbane objekt prokurimit, janë mallra, artikuj ndërtimi në funksion të projekteve infrastrukturore të bashkive, rrjedhimisht fakti është se operatori në fjalë e përmbush kriterin e përgjithshëm pasi ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

Përsa më sipër pretendimi i OE ankimues, nuk qendron.

Së dyti, lidhur me pretendimin se: “Oferta e paraqitur nga OE “LEON KONSTRUKSION” sh.p.k, nuk plotëson kriterin e kualifikimit për punë të ngjashme.”

Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentet e tenderit, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, objektet kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jetë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 4096 (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues. Për përmbushje të kriterit të mësipërm, ofertuesi “LEON KONSTRUKSION” sh.p.k ka realizuar kontrata furnizimesh me autoritetin FSHZH me objekt dhe vlera (me dhe pa TVH), si më poshtë:

1.Mbështetje me furnizim materiale mobilimi urban për Bashkinë Dropull”, Bashkia Dropull; 950,000.00 -----1,141,000.00

2. Mbështetje me furnizim matariale mobilimi urban me lëndë të parë, Bashkia Kuçovë, - Bashkia Lushnje 1,045,000.00----1,254,000.00

3. Mbështetje me furnizim materiate mobilimi urban me lëndë të parë, Bashkim delvine - Bashkia Mat 1,990,000.00--- 2.388,000.00

4.Mbështatje me fumizim materiale mobilimi urban ma lëndë të parë-Bashkitë- Bulqizë-Finiq-Konispol-Memaliaj 5,225,000.00----6,270,000.00

5.Mbështetje me furnizim materiale mobilimi urban me lëndë të parë-Divjakë, Kukës, Lushjne, Rrogozhinë 10,538,000.00-----12,645,600.00

6.Mbështetje me furnizim materiale mobilimi urban me lëndë të parë-Lezhe-Mirdite-M. Madhe 7,830,000.00-----9,396,000.00

7. Mbështetje me furnizim materiale mobilimi urban per realizimin e punimeve parër projektin: Rehabilitimi i rrugës Pjeter Budi” Bashkia Klos 1,880,0.00---2,256,000.00

8. Mbështetje me furnizim materiale mobilimi urban per realizimin e punimeve për projektin: “Rehabilitimi i shesheve prane zonave te banuara në qytetin Peshkopi”, bashkia Dibër, “Materiale për ndërtim dhe ndriçim trotuari për fshatin –Cermë Sipër-Çermë Sektor” Bashkia Divjakë 6,850,000.00---8,220,000.00

9. Mbështetje me furnizim matariale urbanë, për realizimin e punimeve për projektin: “Rrugë hyrëse fshati Dragot, Rrugë e brendshme qytet Tapelenë, Rrugë e brendshme fshati Maraj, Rrugë e brendshme lagjia Majkosh, Rrugë e brendshme lagjia Majkosh, rrugë e brendshme lagjia SMT (Soradol), Bashkia Tepelenë 6,311,000.00---7,573,200.00

10. Mbështetje me furnizim materiale urbane, për realizimin e punimeve për projektin: “Sistemimi sheshit përpara qendrsx shëndetësore Savër, Njësia Administrative 5” dhe “Shtrim me trotuar në rrugën kryesore në fshatin Piug, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnje 1,800,000.00---2,160,000.00

11. projektin: “Mbështetje me furnizim materiale urbane, për realizimin e punimeve për projektin: “Matarisle ndertimi, Matariale KUZ dhe mobilim urban për qytetin Libohovë dhe fshatrat Baillo, Cupral, Koncke, Labove, Locan, Suhë, Bashkia Libohovë 3,104,000.00---3,724,800.00

12. Mbështetje me furnizim materiale urbane, për realizimin e punimeve për projektin: “Rruga e Llixhave Sarandapor, Njesia Administrative Leskovik”, Bashkia Kolonje 725,000.00---870,000.00

13. Mbështetje me furnizim materiale urbane, për realizimin e punimeve për projektin: “Mobilimi urban në disa zona të Beratit”, Bashkia Berat: “Implementim trotuar këmbesorësh rruga Lezhë Shënkoll”, “Sheshi Drin 1, Lagjia 5,060,000.00---6,072,000.00

14. Mbështetje me furnizim matariale ndertimi me lande te pare, per realizimin e punimeve për projektin: “Mobilim urban ne njasi te ndryshme administrative te qytetit te Elbasanit, Labinot Mal, Shushicë, Bradashesh, NJANr.3, NJANr.6 8,035,000---9642,000.000

15. Mbështetje me furnizim materiale urbane, për realizimin e punimeve për projektin: “Përmirësimi i infrastrukturës për manaxhimin e integruar të mbetjeve urbane Bashkia Sarandë 2,625,000.00---3,150,000.00

16. Mbështetje me furnizim matariale urbane, për realizimin e punimeve për projektin: Vendorsje e stolave dhe kazaneve plastike në rrugët dhe hapësirat publike të Nj.A Burrel, Lis dhe Koms, Bashkia Mat 4,175,000.00---5,010,000.00

17. Mobilimi urban ne bashkine Shkodar , Drisht, Shiroke, Velipoje dhe Theth”, Bashkia Shkodër 6,780,000.00---8,136,000.00

Dokumentacioni i paraqitur nga OE, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor pasi kontratat e mësipërme janë

kontrata furnizimesh ne përputhje me kriterin e parashikuar në dokumentet e tenderit dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, sipas përmbajtjes të nenit 40 “Kërkesat e veçanta të kontratave të mallrave”, në pikën 4 ndër të tjera parashikohet: “4 Për të provuar përvojën e mëparshme..Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i perfundimit të kontratës ose dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas ;egjilacionit në fuqi ku shënohen data, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Siç shihet nga kjo dispozitë për të vërtetuar përvojën e ngjashme duhen këto dëshmi:

a) Nga entet publike:

- Vërtetim nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës së furnizimit
Ose dhe fatura tatimore shite për sasi të mallrave të furnizuara

b) Nga sektori privat:

- Fatura tatimore të shitjes

OE “LEON KONSTRUKSION” sh.p.k ka dorëzuar për vitin 2022-2023, fatura tatimore të fiskalizuara nr.50,52,53,55,39,37,36,30,29,28,25,19,8,6,7,4,5,3,2,106,101,95,94,89,93,87,88,77,79,80,81. Nga shqyrtimi këto kontrata/fatura plotësojnë, objektin e prokurimit, elementin kohë dhe elementin vlerë 40% të fondit limit sikurse percaktuar në pikën 2.3.1 të Dokumentave Standarte të tenderit (Loti 4) dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021. KSHA gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Përsa më sipër pretendimi i OE ankimes, është i pa mbështetur në ligj dhe në prova rrjedhimisht pretendimi, nuk qendron.

Së treti, në lidhje me pretendimin “Oferta e paraqitur nga OE “LEON KONSTRUKSION” sh.p.k., nuk plotëson kriterin e kualifikimit për disponimin e mjeteve të transportit të mallrave”KSHA arsyeton:

Referuar në dokumentet e tenderit Shtojca 7, në pikën pika 2.3.3 është përcaktuar:

Operatori duhet të disponojë të paktën 4 mjete që nevojiten me qëllim transportin e mallrave të cilët duhet t'i ketë në pronësi ose me qira

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamion me vinc	4	Pronesi ose me qera

Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit, leja e qarkullimit: -çertifikaten e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshem. Për mjetet që janë me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit, Autoriteti enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE dhe dokumentacionit fizik të dorëzuar nga ofertuesi “LEON KONSTRUKSION” sh.p.k. rezulton se për përmbushjen e kriterit ofertuesi ka plotësuar shtojcën 8 “Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit”, ku ka deklaruar katër mjete Kamion me vinc konkretisht: AB417KN, AA823PA, AA518DJ, GJ1127B. Ndërkohë për këto mjete ka dorëzuar si dëshmi dokumentacionin e kërkuar për vërtetimin e regjistrimit të mjetit, leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjeteve, kontratë huaje.

Për sa më sipër pretendimi, nuk qendron është i pa mbështetur në ligj dhe në prova.

Në mbështetje të Nenit 114 pika 3/c të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 102 pika 1/c a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi: Të refuzojë ankesën e operatorit ekonomik “Alb Garden” sh.p.k NUIS K37513520N për procedurën e prokurimit “E hapur” Marrëveshje Kuadër Loti 4: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët - materiale mobilim urban lëndë e parë Faza II”, REF-74544-07-07-2023, me fond limit 104,166,667 lekë pa TVSH.

Lutemi, bashkëlidhur gjeni: Kthimin e përgjigjes lidhur me ankesën e OE “AlbGarden” sh.p.k NUIS K37513520N.”

II.8. Me shkresën nr.2387/4 prot., datë 13.10.2023 KPP ju drejtua autoriteti kontraktor me kërkesën si vijon: “[...] Aktualisht, me anë të shkresës Nr.3207/1 prot., datë 03.10.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr.2387/3 prot., datë 05.10.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e mësipërme të prokurimit, sipas të cilit është vendosur mospranimi i ankesës.

Në vijim të komunikimit, me qëllim shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues duhet të paraqisni pranë KPP-së, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja dijani e kësaj shkrese, dokumentacionin e plotë të dorëzuar pranë autoritetit tuaj kontraktor, nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK, në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar”, sa i takon plotësimin të kriterit të kualifikimit të përcaktuar në shtojcën 7, “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/ kualifikimit”, 2. Kriteret e Veçanta të kualifikimit, 2.9 kapaciteti teknik, pika 2.3.3, lidhur me disponimin e mjeteve që nevojiten me qëllim transportin e mallrave, të cilat operatori ekonomik duhet t’i ketë në pronësi ose me qira.”

II.9. Me shkresën nr. 3207/3 prot., datë 17.10.2023 protokolluar me tonën me nr. 2387/5 prot., datë 18.10.2023 autoriteti kontraktor ka depozituar në KPP informacionin e kërkuar nga KPP në shkresën me sipër duke i bashkëngjitur shkresës dokumentacionin e depozituar nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK në autoritet kontraktor në përmbushje të kriterëve kualifikuese të cilat janë objekt i ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albgarden” SHPK se operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK nuk ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, KPP vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 për lotin 4 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, germa “a” e dokumentare të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

[...]

Këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

III.1.2. Në shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, ndër të tjera, parashikohet se:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITERËVE TË PËRGGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<i>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</i>
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>

III.1.3. Nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK rezulton se është paraqitur:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<i>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</i>
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>

III.1.4. Neni 25 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” i VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se:

“Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Këto kriteret synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.”

III.1.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të

përshatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për 14 përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.8. Lidhur me pretendimet e ankimesit për sa i përket objektit të veprimtarisë së operatorit ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në fjalë rezulton se në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, gërma “A” “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, është deklaruar: “Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.”

Gjithashtu nga verifikimi i Ekstraktit historik të regjistrit për të dhënat e subjektit “Leon Konstruksion” SHPK, të publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit

rezulton se objekti i aktivitetit është përcaktuar: “*Ne fushen e ndertimit : Germime dheu me punime eventuale murature e beton arme, prishje dhe punime ne toke te germuar, prodhim materiale ndertimi, ndertime civile dhe ekonomike, rrugore. Ndertime hekurudhore, ura dhe vepra arti, detare, hidraulike dhe hidroteknike. Vepra te veçanta e punime speciale restaurimi, karpentierie, impiante teknologjike e te veçanta. Punime montimi ne impiantet e prodhimit dhe shperndarjes se energjise. Punime sherbimi, topogjeodezike. Ne fushen e tregtise: Tregtim te artikujve te ndryshem me shumice dhe pakice te lejuara nga ligji. Import, eksport. Transport mallrash brenda dhe jashte vendit. Transport mbetjesh te rrezikshme dhe jo te rrezikshme. Stacion transferimi mbetjesh te rrezikshme dhe jo te rrezikshme. Veprimtari e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis, vleresim ndikimi ne mjedis (auditimi mjedisor). Veprimtari te tjera profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis, grumbullim dhe transportim i mbetjeve te ndertimit dhe prishjeve dhe mbetjeve te ngurta urbane. Servis dhe mirmbajtje Makinash, riparim dhe rehabilitim ne fushen e automatizimit industrial ne makineri, mjete, pajisje. Lavazh Mjetesh, Tregtim Karburanti. Ne fushen e studimit dhe projektimit urbanistik. Ne fushen e studimit dhe projektimit Arkitektonik. Ne fushen e studimit dhe projektimit konstruktiv. Ne fushen e studimit dhe projektimit Instalator duke pershire Projektim te instalimeve hidro-termosanitare. Projektim te instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme. Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, per objekte civile e industriale. Projektim te sistemeve komplekse te telekomunikacionit. Projektim te sistemeve te furnizimit me gaz. Projektim te sistemeve kundra zjarrit. Projektim te sistemeve te monitorimit dhe automatizimit ne industri dhe ndertesa. Projektimi i impianteve ngritese e transportuese (ashensore, shkalle levizese etj.). Projektimi i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndricimit te objekteve te medha sportive, porteve aeroportive etj. Projektim te rrjeteve te telefonise, citofonise, fonise, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit te zjarrit etj., per objektet civile e industriale. Ne fushen e studimit dhe projektimit te veprave hidraulike. Ne fushen e studimit dhe projektimit rrugeve - hekurudhave. Ne fushen e studimit dhe projektimit Ura vepra arti. Ne fushen e studimit dhe projektimit Gjeodezike. Ne fushen e studimit GjeologoInxhinierik - Hidrogeologjik. Ne fushen e studimit dhe projektimit i impianteve te prodhimit dhe shperndarjes se energjise elektrike. Ne fushen e studimit dhe projektimit te sinjalizimit rrugor. Ne fushen e studimit dhe projektimit te sizmologjise inxhinierike. Ne fushen e studimit dhe projektimit te ndertimit dhe mbylljes se vend-depozitimeve te mbetjeve te ngurta. Ne fushen e studimit dhe projektimit te ndertimit te impianteve te trajtimit te ujerave te zeza. Punime Projektimi dhe zbatimi e restaurimi ne monumentet e arkitektures, restaurimi i monumenteve te trashegimise kulturore, nderhyrje ne qendra historike dhe kulturore. Ndertime impiante per prodhimin e energjise elektrike, nenstacioneve dhe kabina te tensionit te larte, te mesem dhe te ulet. Agjenci imobiliare, konsulence, marketing, gen- plan, ndermjetesim shitje, blerje, dhenie apo marrje me qira te pronave te paluajtshme, studime tregu te pasurive te paluajtshme etj.”*

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Leon Konstruktion” SHPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nga ana e tij është plotësuar formulari i pergjithshëm i vetëdeklarimit, ku deklarohet se ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, si dhe në objektin e veprimtarisë së shoqërisë “Leon

Konstruksion” SHPK, sipas ekstraktit historik si më sipër cituar rezulton se përfshihet objekti i prokurimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Albgarden” SHPK, për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK, me arsye se ky operator ekonomik nuk plotëson kriterin:“ 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.” KPP vëren se,

III.2.1 Në shtojcën 7 për lotin 4 të dokumentave të tenderit, “kriteret e veçanta të kualifikimit”, “2.9 kapaciteti teknik” pika 2.3.1 është parashikuar kriteri si më poshtë:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.2.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik ”Leon Konstruksion” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë nr. 1201 prot., datë 16.11.2020 të lidhur me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura me objekt ”Sistemim i peligrinazhit bektashian në Parkun Kombëtar”

bashkëlidhur së cilës ndodhen edhe situacionet përfundimtare dhe preventivet e punimeve si dhe fatura tatimore e shitjes nr. 40, datë 14.12.2020 dhe fatura elektronike nr.23/2021, datë 26.08.2021;

- *Shtojcë kontrate me objekt:Sistem i zonës së pelegrinazhit bektashian në Parkun Kombëtar "Mali i Tomorrit"*
- *Shkresa me nr.1132 prot., e majit 2021 ne lëndë: "Kërkesë për zgjatjen e afatit të përfundimt të punimeve për objektin "sistem i zonës së peligrinazhit bektashian në Parkun Kombëtar "Mali i Tomorrit"*
- *Procesverbal kolaudimi ekniko-ekonomik i datës 24.08.2021*
- *Certifikatë e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me nr. 976/2 prot., datë 26.08.2021;*
- *Kontratë me nr. 1192 prot., datë 09.06.2020 e lidhur mes Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe BOE"Leon Konstruksion" SHPK & "Llazo" SHPK me objekt "Rindërtim i objektit arsimor "Shkolla 9-vjecare Gosë" bashkëlidhur së cilës gjenden situacione e punimeve si dhe faturat: Faturë tatimore shitje nr. 18, datë 06.07.2020; Faturë tatimore shitje nr. 26 datë 09.09.2020; Faturë tatimore shitje nr. 31 datë 23.01.2022; faturë tatimore shitje nr. 33, datë 20.11.2020; Faturë elektronike nr. 3 datë 21.11.2020*
- *Procesverbal kolaudimi me objekt" Rindërtim i objektit arsimor: "Shkolla 9-vjecare Gose"*
- *Shkresa me nr. 843/1 prot., daë 23.03.2021 me lëndë: " Dërgim i certifikatës së marrjes në dorëzim të përkohshëm dhe listën e inventarit të objektit:" Rindërtim i shkollës "9 vjecare Gosë"*
- *Cetifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve për emertimin e kontratës: "Rindërtim i shkollës 9 vjecare "Gosë"*
- *Kontratë furnizimi e datës 03.08.2023 e lidhur mes shoqërisë "Leon Konstruksion dhe "Tafil Met-hasani"*
- *Kontratë furnizimi e datës 08.08.2023 e lidhur mes Zija Daka PF (furnizuesi) dhe shoqërisë "Leon Konstruksion" (porositësi) sipas së cilës furnizuesi do të furnizojë porositësin me produktet bime, peme, lule, lule dekorative, peme dekortive, fidan, frutore, arrore sipas kërkesave të porositësit.*
- *Faturë tatimore shitje me nr. 35, datë 30.11.2020 bashkëlidhur se cilës gjendet situacioni i punimeve me emertesë të punimeve: mbushje me dhe; mbushje me humus:F.V peme bliri; F.V shkurre; F.V fikus benjamin lartesia 150-200 cm; F.V Ficus benjamin lartësia 150-200cm; F.V dracena Lartesia 150-200 cm; F.v Zamioculcas; F.V Pishe; F.V Rrap, F.V Ylqe; f.v Citrus japonica 80-100 cm.*
- *Faurat e lidhura mes shoqërisë "Leon Konstruksion" SHPK dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit me numër dhe datë si më poshtë:*
NR. FATURE dhe DATE
- *77, date 2022-11-04*
- *79, date 2022-11-11*
- *80, date2022-11-11*
- *81, date 2022-11-23*
- *85, date 2022-12-01*
- *"87, date 2022-12-05*

- 88, date 2022-12-06
- 89, date 2022-12-06
- 93, date 2022-12-08
- 94 ,date 2022-12-08
- 95, date 2022-12-08
- 101, date 2022-12-14
- 106, date 2022-12-19
- 2, date 2023-01-11
- 3, date 2023-01-12
- 4, date 2023-01-12
- 5, date 2023-01-14
- 6, date 2023-01-14
- 7, Date 2023-01-18
- 8, date 2023-01-18
- 19, date 2023-03-01
- 25, date 2023-03-28
- 28, date 2023-04-11
- 29, date 2023-04-13
- 30, date 2023-04-17
- 36, date 2023-05-09
- 37, date 2023-05-10
- 39, date 2023-05-19
- 50, date 2023-07-10
- 52, date 2023-07-12
- 53, date 2023-07-27
- 55, date 2023-07-31

Në përbërje të të cilave ka zëra si stola me krahë gize me permasa, kosha mbeturinash me lartesi 1 m; kazane plastik te vegjel 0.5 m³;stola betoni; stola druri komplet.

III.2.3. Në shtojcën “Preventiv pa cmime material urban” është përcaktuar:

Nr	Emertimi i Materialeve	NJESIA	Sasite Totale	Çmimi	Vlefte
IV Mobilimi urban					
110	Stola me krahe gize me permasa 150*60*75	cope	1,678		
112	Stola betoni	cope	400		
113	Kosha mbeturinash te montueshem me lartesi 1m dhe kapacitet 10 kg	cope	1,500		
116	Kazane plastik te vegjel 0.5 m ³	cope	400		
Gjelberim					
n. 169	Fidane peme dekorative Bli (sp)	cope	1,000		
n 164	Fidane peme dekorative Ilqe	cope	1,000		
n 164	Fidane peme dekorative Rrap (sp)	cope	1,000		
An164	Fidane peme dekorative Pische (sp)	cope	1,000		
An165	shkurre oleander	cope	1,996		
Lot 1 (Fondi Limit) pa TVSH			Materiale mobilim urban		
Lot 1 (Fondi Limit) me TVSH			Materiale mobilim urban		

III.2.4. Në shtojcën “Specifikime teknike mobilim urban” është përcaktuar:

IV. Specifikime teknike (Mobilim Urban)

MOBILIMI URBAN

Stola me krahe gize me permasa 150*60*75

Stol me krahë gize, 150x60x75 cm dhe listela druri të lyera me bojë speciale me pjekje, për t'i rezistuar agjentëve atmosferikë dhe rrezeve UV. Trashësia minimale e listelave 5cm. Pesha e stolit minimumi 75 kg.

Zeri i Materialit:

- **Stola me krahe gize me permasa 150*60*75**

Stola betoni

Stolat do të jenë të parapërgatitur me beton të klasës minimale C30/37. Sipërfaqja e betonit do të jetë e pastër. Betoni nuk duhet të ketë ujë thithje. Lartësia e uljes 45-50cm.

Zeri i Materialit:

- **Stola betoni;**

Kosha

Kosha mbeturinash te montueshem me lartesi 1m dhe kapacitet 10 kg

Rezistent ndaj kushteve atmosferike. Rezistent ndaj insekteve.

- Kapaciteti : 10 kg.
- Te jete i hapshem .
- Te jete rezistente ndaj goditjeve .

Materiali te plotesoje standartet e cilesise sipas normativave perkatese.

Kazane plastik te vegjel 0.5 m3

Te jene material plastik, cilesore, me kapake, te pastrohen lehtesisht nga njollat dhe papasterite.

Rezistent ndaj kushteve atmosferike.

Materiali te plotesoje standartet e cilesise sipas normativave perkatese.

Reziastent ndaj insekteve.

Materiali: Politilen.

Spesori : 5 - 10 mm.

Zerat e Materialeve:

- **Kosha mbeturinash te montueshem me lartesi 1m dhe kapacitet 10 kg**
- **Kazane plastik te vegjel 0.5 m3**

V. Specifikime teknike (Gjelberim)

1. PEME DEKORATIVE

1.1 Blin (Tilia sp)

Lartesia l > 4 m

Perimetri C = 16-18 cm

Lartesia e trungut pa degezime > 1,2 m

Trungu i drejte

Kurora e rregullt

Te kene mbi 2 vjet ne vazo

Te plotesoje kriteret e VKM Nr.523 date 13.07.2016 per percaktimin e kriterëve te tregetimit e certifikimit te fidaneve te bimeve zbukuruese.

1.2 Rrap (Platanus sp)

Lartesia l > 4m

Perimetri C = 14-16 cm

Lartesia e trungut pa degezime > 1 m

Trungu i drejte

Kurora e rregullt

Te kene mbi 2 vjet ne vazo

Te plotesoje kriteret e VKM Nr.523 date 13.07.2016 per percaktimin e kriterëve te tregetimit e certifikimit te fidaneve te bimeve zbukuruese.

1.3 1.3 Ilqe (Quercus Ilex)

Lartesia l > 4m

Perimetri C = 14-16 cm

Lartesia e trungut pa degezime > 1 m

Trungu i drejte

Kurora e rregullt

Te kene mbi 2 vjet ne vazo

Te plotesoje kriteret e VKM Nr.523 date 13.07.2016 per percaktimin e kriterëve te tregetimit e certifikimit te fidaneve te bimeve zbukuruese.

1.4 Pishe (Pinus sp)

Lartesia l > 4m

Perimetri C = 14-16 cm

Lartesia e trungut pa degezime > 1 m

Trungu i drejte

Kurora e rregullt

Te kene mbi 2 vjet ne vazo

Te plotesoje kriteret e VKM Nr.523 date 13.07.2016 per percaktimin e kriterëve te tregetimit e certifikimit te fidaneve te bimeve zbukuruese.

2 SHKURRE DEKORATIVE

2.1 Oleander (*Nerium Oleander*)

Lartesia l > 1,5 m

Te kene mbi 3 degezime

Te kene mbi 2 vjet ne vazo

Te plotesoje kriteret e VKM Nr.523 date 13.07.2016 per percaktimin e kriterëve te tregimit e certifikimit te fidaneve te bimeve zbkuruese.

III.2.5. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përputhje me

dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e përvojës së ngjashme ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit për të cilin ata konkurrojnë për të fituar kontratën publike. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Leon Konstruktion” SHPK për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.2.2 të këtij vendimi.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albgarden” SHPK lidhur me mospërmbushjen nga operatori ekonomik “Leon Konstruktion” SHPK të kriterit për vërtetimin e shërbimeve të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit të përcaktuar në “kriteret e vecanta” të kualifikimit, “kapaciteti teknik” pika 2.3.1 të dokumenteve të tenderit si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Leon Konstruktion” SHPK në lidhje me kontratat e ngjashme, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik “Leon Konstruktion” SHPK e plotëson kriterin e mësipërm të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, për sa i përket vërtetimit të realizimit të shërbimeve të ngjashme. KPP-së i mjaftoi vetëm analizimi i faturave tatimore të lidhura mes operatorit ekonomik “Leon Konstruktion” SHPK

dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit si dhe fatura me nr.35, datë 30.11.2020 e lidhur me "Albaelectrica" SHPK ku nga përshkrimi i mallit të faturave tatimore rezulton se zërat e tyre mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit si dhe vlera e tyre e kalon 40 % të vlerës së fondit limit të lotit 4 objekt ankimi.

KPP pasi i veçoi faturat tatimore më sipër zërat e të cilave mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, vëren se vlera e tyre prej x lekë pa TVSH arrin të përmbushë vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit në masën prej 40% të fondit limit duke përmbushur në këtë mënyrë të gjithë komponentët e kërkuar nga kriteri në lidhje me: kohën (të lidhura brenda 3 vitesh nga publikimi i njoftimit të kontratës), ngjashmërinë e zërave (stola me krahë gize me permasa, kosha mbeturinash me lartesi 1 m; kazane plastik te vegjel 0.5 m³;stola betoni; stola druri komplet dhe furnizim vendosje pemësh) si dhe vlerën (jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit). Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik "Leon Konstruksion" SHPK me dokumentacionin e paraqitur provon se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi ato zëra të kontratave apo faturave që KPP i konsideroi si të ngjashëm me objektin e prokurimit mjaftojnë për të plotësuar vlerën e kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron shërbime të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, kërkesë kjo e cila është plotësuar nga ana e operatorit ekonomik "Leon Konstruksion" SHPK.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Albgarden" SHPK, për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "Leon Konstruksion" SHPK, me arsyen se ky operator ekonomik nuk plotëson kriterin:" 2.3.3 *Operatori duhet të disponojë të paktën 4 mjete që nevojiten me qëllim transportin e mallrave, të cilët duhet t'i ketë në pronësi ose me qira. Nr. Mjetet Sasia Gjendja*

1 Kamion me vinç 4 Pronësi ose me qira

- *Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit, leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshëm.*
- *Për mjetet që janë me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese. " KPP vëren se,

III.3.1 Në shtojcën 7 për lotin 4 të dokumentave të tenderit, “kriteret e veçanta të kualifikimit”, “2.9 kapaciteti teknik” pika 2.3.3 është parashikuar kriteri si më poshtë:

2.3.3 Operatori duhet të disponojë të paktën 4 mjete që nevojiten me qëllim transportin e mallrave, të cilët duhet t'i ketë në pronësi ose me qira.

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamion me vinç	4	Pronësi ose me qira

- Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit, leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshëm.
- Për mjetet që janë me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

III.3.2. Në shtojcën “Preventiv pa cmime material urban” është përcaktuar:

Nr	Emertimi i Materialeve	NJESIA	Sasite Totale	Çmimi	Vleftha
IV	Mobilimi urban				
110	Stola me krahe gize me permasa 150*60*75	cope	1,678		
112	Stola betoni	cope	400		
113	Kosha mbeturinash të montueshem me lartesi 1m dhe kapacitet 10 kg	cope	1,500		
116	Kazane plastik të vegjel 0.5 m ³	cope	400		
	Gjelberim				
n. 169	Fidane peme dekorative Bli (sp)	cope	1,000		
n 164	Fidane peme dekorative Ilqe	cope	1,000		
n 164	Fidane peme dekorative Rrap (sp)	cope	1,000		
n164	Fidane peme dekorative Pishe (sp)	cope	1,000		
n165	shkurre oleander	cope	1,996		
	Lot 1 (Fondi Limit) pa TVSH		Materiale mobilim urban		
	Lot 1 (Fondi Limit) me TVSH		Materiale mobilim urban		

III.3.3. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, për lotin 4 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2/a, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

III.3.4. Në shtojcën 8 të dokumenteve standarde të tenderit autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- ---
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- --
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

• **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	N IPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me të për t'u nënkontraktuar

• **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	N IPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata				
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:				
etj.				
nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				

<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e

saktë në çdo aspekt;

3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;

5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;

b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

a) çmimet ;

b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë

deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p>
<p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:</p> <p>-Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.</p> <p>Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni,</p>

për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
<ul style="list-style-type: none">Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga

legjislacioni i punës në fuqi.

- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.

- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <p>Profili i punonjësve</p> <p>_____</p> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p>
<p>Emri, Mbiemri _____</p> <p>Firma _____</p> <p>Vula _____</p> <p>Data e dorëzimit të deklaratës _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

-Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.

-Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

-Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.

-Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraparak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.3.5. Në shtojcën 7 për lotin 4 të dokumentave të tenderit, “kriteret e veçanta të kualifikimit”, “2.9 kapaciteti teknik” pika 2.3.3 është parashikuar kriteri si më poshtë:

2.3.3 Operatori duhet të disponojë të paktën 4 mjete që nevojiten me qëllim transportin e mallrave, të cilët duhet t'i ketë në pronësi ose me qira.

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamion me vinç	4	Pronësi ose me qira

Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit, leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshëm.

Për mjetet që janë me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

III.3.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Leon Konstruktion” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mesiperm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacion si më poshtë vijon:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

III.3.7. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij

formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në cdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.3.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.3.9. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: I.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.3.10. Në nenin 40, pika 5 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) *licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

III.3.11. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili nga verifikimi konstatohet, se është plotësuar sipas Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit.

III.3.12. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ky i fundit konstaton, se operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike në përmbushje të kriterëve për të cilat operatori ekonomik ankimues ngre pretendime. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, konstatohet, se operatori ekonomik “Leon Konstruksion”, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën III, B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, në lidhje me mjetet ka deklaruar, se disponon mjetet e kërkuara nga autoriteti kontraktor, duke i listuar ato si më poshtë:

- Kamion me vinc, AB417 KN, TRF09050323,WDB6763161L283151, Mercedes Benz;
- Kamion me vinc, AA823PA, DRD1746316, EDB9505031K544678, Nr 592 Rep Nr 193 Kol, 08.02.2022-07.02.2027;
- Kamion me vinc, AA518DJ, FRF0633112, WMA5200660M061466, Nr 663 Rep Nr 219 Kol, 11.02.2022-10.02.2027;
- Kamion me vinc, GJ1127B, GJD0005152,WDB65121215904945, nr 3073 REP Nr 1037 Kol, 18.09.2020-13.09.2025.

III.3.13. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht “Operatori duhet të disponojë të paktën 4 mjete që nevojiten me qëllim transportin e mallrave, të cilët duhet t'i ketë në pronësi ose me qira.

[...].Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit, leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshëm.

Për mjetet që janë me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese..”

Gjithashtu referuar po këtyre pretendimeve, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku në pjesën III, është plotësuar pika B “DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, ku konstatohet, se janë deklaruar mjetet që disponon.

Për këtë arsye, duke qenë se operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK është kualifikuar i pari në procedurën e prokurimit, KPP në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Albgarden” SHPK, për skuafikimin e operatorit ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK, me anë të shkresës nr.2387/4 prot., datë 13.10.2023 i kërkoj autoritetit kontraktor, të dorëzojë pranë KPP-së dokumentacionin e plotë të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK, në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar”, sa i takon plotësimin të kriterit të kualifikimit të përcaktuar në shtojcën 7, “Formular i kriterëve të përzgjedhjes/ kualifikimit”, 2. Kriteret e Veçanta të kualifikimit, 2.9 kapaciteti teknik, pika 2.3.3, lidhur me disponimin e mjeteve që nevojiten me qëllim transportin e mallrave.

Nëpërmjet shkresës me Nr.3207/3 prot., datë 17.10.2023, protokolluar me tonë me nr. 2387/6 prot., datë 18.10.2023 autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK, për përmbushjen e kriterëve objekt i ankesës gjithsej 48 faqe.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konstatohet, se operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK, në përmbushje të kriterit 2.3.3. në dokumentet e tenderit, për loti 4 për disponimin e mjeteve ka dorëzuar dokumentet si më poshtë:

- *Për mjetin me targa TR5434F me numër shasie WDB6763161K283151(i pa deklaruar në shtojcën 8) dhe në pronësi të Leon Konstruksion ka dorëzuar:; certifikatën e pronësisë, leje qarkullimi, policë sigurimi, taksë vjetore, certifikatë e kontrollit teknik të mjetit, certifikatë e kryerje së operacionit teknik;*

- *Për mjetin me targë AA 823PA (i deklaruar në formular) ka dorëzuar; kontratë huapërdorje me nr. repertori 592, nr. koleksioni:193 e datës 08.02.2022,certifikate e pronësisë se mjetit, certifikate kontrolli teknik, leje qarkullimi, police sigurimi, takse vjetore, certifikate per transport mallrash për llogari të vet nga Bashkia Tiranë, foto të mjetit;*

- *Për mjetin me targë AA518 DJ (i deklaruar në formular) ka dorëzuar: kontratë huapërdorje me nr. repertori 663, nr. koleksioni 219 e datës 11.02.2022, certifikatë pronësie e mjetit, leje qarkullimi, kontroll teknik, taksë vjetore, police sigurimi, foto të mjetit;*

- *Për mjetin me targë GJ1127B (i deklaruar në formular) ka dorëzuar: kontratë qeraje me nr. 3073 Rep, nr. 1037 Kol. E datës 18.09.2020 certifikatë pronësie e mjetit, leje qarkullimi, kontroll teknik,taksë vjetore, police sigurimi, foto të mjetit;*

- Për mjetin me targë AB417KN (i deklaruar në formular) me numër shasie WDB6763161K283151 (i deklaruar në formular) ka dorëzuar: leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, foto.

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se: “Mjetete e deklaruara nga Leon Konstruksion” SHPK në shtojcën 8 Formulari i Përmbledhës i Vetëdeklarimit janë të ndryshme nga mjetet të cilat janë dorëzuar po nga ky OE gjatë paraqitjes së dokumentacionit fizik pranë AK[...], nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) konkretisht, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK, si dhe verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, KPP konstaton, se ky i fundit, në përmbushje të kriterit të mësipërm, ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar me anë të cilit vërteton disponimin e mjeteve të nevojshme të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin kualifikues më sipër. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK në përmbushje të kriterëve për të cilat operatori ekonomik “Albgarden” SHPK ngre pretendime rezulton se mjetet e deklaruara nga operatori ekonomik në shtojcën 8”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” janë të njëjta me ato të cilat operatori ekonomik Leon Konstruksion” SHPK ka dorëzuar në autoritet kontraktor duke shtuar këtu faktin që për automjetin me targë TR5434F me numër shasie WDB6763161K283151(i pa deklaruar në shtojcën 8) dhe në pronësi të Leon Konstruksion referuar numrit të shasisë është i njëjtë me mjetin AB 417 KN të cilin operatori ekonomik e ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Ndërsa referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues se “Referuar lejes së qarkullimit të paraqitur nga OE “Leon Konstruksion”shpk rezulton se mjetet e paraqitura nuk e kanë shënimin e vecantë në lejen e qarkullimit që provon se këto mjete janë për përdorim apo transport të vecantë. Ky fakt bie në kundërshtim të plotë me kriterin e kërkuar në dst nga AK” si dhe pretendimin që “Në rastin konkret rezulton se OE “Leon Konstruksion”Shpk nuk ka dorëzuar dokumentin certifikatë për transport për të tretë dhe me qira”e për rrjedhojë kontrata e qirasë e paraqitur nga ky OE është e pavlefshme duke mos përmbushur kështu kriterin e kualifikimit të disponimit të 4 mjeteve (kamion vinc) të kërkuara nga AK në dst”, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor në këtë kriter kualifikues nuk ka kërkuar që të paraqitet në lejen e qarkullimit elementi provues që këto mjete janë për përdorim apo transport të vecantë si dhe nuk ka kërkuar dokumentin certifikatë për transport për të tretë dhe me qira. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues “Leon Konstruksion” ShPK, si dhe dokumentacioni i dorëzuar në rrugë shkresore pranë autoritetit kontraktor në përmbushje të kriterit për të cilin ngrihen pretendime konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentacionin provues në lidhje me disponimin e mjeteve sic është kërkuar në kriterin për kualifikim të përcaktuar në kriteret e veçanta të kualifikimit”, “2.9 kapaciteti teknik” pika 2.3.3. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “Leon Konstruksion” ShPK me dokumentacionin e paraqitur në SPE dhe dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, si operator ekonomik i kualifikuar i pari plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar më sipër.

Sa më lart pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Albgarden” SHPK se “Leon Konstruksion” nuk plotëson kriterin e kualifikimit për plotësimin e shtojcës 8 FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT sipas përcaktimeve të AK. Nga verifikimi i shtojcës 8 FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT të përpiluar dhe dorëzuar nga OE “Leon Konstruksion” shpk rezulton se të dhënat e paraqitura në këtë formular nuk janë të sakta. Më konkretisht të dhënat e paraqitura nga OE “Leon Konstruksion” shpk për mjetet e kërkuara si dhe për kontratat e ngjashme rezultojnë të jenë të pa sakta. Në këto kushte ky OE duhet të skualifikohet” KPP gjykon se referuar arsyetimit më sipër lidhur me disponimin e mjeteve ky pretendim nuk qëndron. Po ashtu edhe pretendimi në lidhje me disponimin e kontratave të ngjashme nuk qëndron pasi kontratat e ngjashme nuk janë kriter që përmbushen përmes deklaratimit së pari në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit.

Sa më lart pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.5. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron, se autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit/shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të ligjit për prokurimin publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në 10 një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranohet ankesën e operatorit ekonomik “Albgarden” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-74544-07-07-2023, me objekt: “Loti 4: “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët - materiale mobilim urban lëndë e parë Faza II”, me fond limit 104,166,667.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, sipas legjislacionit të prokurimit publik.

3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albgarden” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri